

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**URDHRI I FARMACISTËVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR**

**MEMO**

**Drejtuar :**

- **Z. Ilir META** Kryetari Kuvendit të Shqipërisë
- **Z. Fatmir XHAFA** Kryetar i komisionit të ligjeve
- **Z. Gramoz RUÇI** Kryetar i grupi parlamentar PS
- **Z. Edi PALOKA** Kryetar i grupi parlamentar PD
- **Z. Petrit VASILI** Kryetar i grupi parlamentar LSI
- **Z. Shpëtim IDRIZI** Kryetar i grupi parlamentar PDIU

Të nderuar zotërinj,

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë përcjell me respekt shqetësimin e vet në lidhje me ndryshimet ligjore të propozuara nga Këshilli i Ministrave për ndryshimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe në ligjet e tjera të paketës fiskale, të cilat janë aktualisht në Kuvendin e Shqipërisë, si ndryshime ligjore që çenojnë ndjeshëm ushtrimin e profesionit të farmacistit në mungesën e plotë të konsultimit me grupet e interesit.

Sikurse Ju jeni në dijeni, këto ndryshime konsistojnë në dhënien e kompetencave ligjore Këshillit të Ministrave për veçimin e kategorive të profesionistëve të lirë nga cdo kategori tjetër biznesi, në lidhje me caktimin e pagës për llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nga ana e Këshillit të Ministrave është propozuar që pas paragrafit të katërt, të nenit 9, “Llojet e kontributeve për t’u paguar”, propozohet të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

***“Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes të kontributeve si dhe kriteret e përcaktimit të saj, deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”***

Në kushtet e reja që ligji autorizon KM, nuk përjashtohet mundësia e caktimit të nivelit të pagave për profesionistët e lirë, përfshi këtu edhe farmacistët, në kufirin e pagës maksimale, si bazë për të cilën llogariten kontributet e sigurimeve në përqindje të caktuar nga ligji.

Një veprim i tillë do të rriste ndjeshëm shumën e këtyre detyrimeve, madje deri në kufirin e falimentimit të biznesit të farmacisë e për pasojë do të hidhte në rrugë një numër të konsiderueshëm të farmacistëve, të cilët realizojnë një xhiro vjetore modeste dhe që janë në kufirin e mos sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për ta dhe familjet e tyre.

Pa dashur të hyjmë në përlllogaritje shifrash, detyrimet që parashikohen nga një veprim i tillë, arrijnë në nivelin mbi 5 herë më të larta se niveli aktual i detyrimeve që ata paguajnë.

Ky propozim është në kundërshtim me frymen e ligjit për sigurimet shoqërore, për faktin se kontributi për sigurimin shoqëror është një detyrim monetar që paguhet edhe nga personi që është i vetëpunësuar, me qëllim përftimin e pensionit të pleqërisë dhe përfitimeve të tjera që ofrohen nga skema e sigurimeve shoqërore të detyrueshme. Në këto kushte, mendimi ynë është se Këshilli i Ministrave ka për detyrë të caktojë vetëm minimumin e pagës mbi bazën e të cilës llogaritet ky detyrim dhe jo pagën brutto të të vetpunësuarit, dhe aq më keq, nëse kjo pagë brutto caktohet në nivelin e pagës maksimale, sikurse është komentuar gjatë këto kohët e fundit nga burime profesionistë të fushës. Argumenti se një veprim i tillë do të rritë ndjeshëm masën e pensionit të kësaj kategorie, na duket jo vetëm i papërshtatshëm për momentin që po kalon shoqëria, por edhe cinik, pasi është dëshirë e çdo të vetë punësuarit që të paguajë kontribute për efekt pension pleqërie në çdo masë që ata e shohin të arsyeshme, në raport me të ardhurat që sigurojnë apo standartit që ata parashikojnë për një gjë të tillë, gjithmonë jo më pak se paga minimale e vendosur nga Këshilli i Ministrave për këtë qëllim.

Hartuesit e projektligjit nuk i janë referuar asnjë treguesi referencial në lidhje me të ardhurat që përfiton një profesionist farmacist nëpërmjet ushtrimit të këtij profesioni. Anëtarët e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë kanë ngritur si shqetësim kryesor, se paga e propozuar, mbi bazën e të cilës është propozuar të llogaritet ky detyrim, është më e lartë se sa vetë të ardhurat mujore, që ata arkëtojnë nga puna e tyre gjatë një periudhë një mujore. Po kështu edhe të ardhurat e personave, që kërkojnë shërbimin farmaceutik janë të ulta, dhe në këtë kuadër nuk ka kuptim që detyrimi për pagimi e kontributit të jetë më i lartë nga e ardhura reale që realizojnë nga puna e tyre farmacistët.

Në profesionin e farmacistit vërejmë dhe një fenomen tjetër i cili nuk vërehet tek profesionet e tjera të lira që është ajo e mos tarifimit të shërbimit.

Pikërisht mungesa e kësaj tarife shërbimi në ushtrimin e profesionit të lirë të farmacistit nuk krijon të ardhura për të dhe si rrjedhojë koncepti i përdorimit në projekt-ligj të sigurimit të një të ardhure më të lartë në krahasim me profesionet e tjera për farmacinë nuk qëndron.

Njëkohësisht ky propozim është diskriminues dhe pengues për farmacistët e rinj që futen në profesionin e farmacistëve, për shkak të konkurrencës në fushën e tregut të farmaceutikës, dhe për këtë arsye të ardhurat që këta mund të realizojnë nga puna e tyre, i çojnë automatikisht në faliment. Në këtë mënyrë projektligji favorizon konkurrencën e pabarabartë të këtyre profesionistëve të futur rishtazi në treg me subjektet farmaceutike të konsoliduara në këtë treg. Kjo do të sjellë për pasojë që shumica dërmuese e farmacistëve të rinj dhe jo vetëm, do të detyrohen të mbyllin veprimtarinë e tyre për shkak të mos përballimit të këtij detyrimi të lartë nga ana e tyre.

Në këto kushte Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, ju drejtohet Ju me këtë memo, prej nga ku kërkohet rrëzimi i ndryshimeve të paraqitura nga ana e KM, diskutimin e ndryshimeve me grupet e interesit, gjithmonë në prizmin e parimeve kushtetuese në drejtim të moscënimit të lirisë ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

Njëkohësisht, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë ju bën me dije se do të përdorë të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore dhe demokratike, për të kërkuar nga hartuesit e këtyre projektligjeve tërheqjen

sa më parë nga ndryshimet e propozuara, që në rastin më të mirë mund të konsiderohen jo profesionale, pasi nëse këto ndryshime kanë suport kapjen e tregut ku operojnë, nga një pjesë profesionistësh të konsoliduar, atëhere projekt ligje të tilla janë kriminale.

Ne besojmë se kërkesa jonë do të vlerësohet dhe ne mbetemi në pritje të një reagimi pozitiv nga ana juaj.

Me respekt dhe besim

Tiranë, më 04.12.2015

**PRESIDENTE**

**Diana Toma**